



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 16. 12.2013, në orën 10.30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Munguan: Justina Shiroka – Pula.

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi, zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit.

Pjesëmarrësit e tjerë: Lejla Selimi- OSBE, Nuredin Ibishi –UNDP, Shkumbin Asllani-CRDP dhe Selvete Gërxhaliu- Grupi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci.

Të ftuar: kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, Prenk Gjetaj, drejtori i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, Arsim Gërxhaliu, përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Agim Gashi dhe përfaqësuesit e AKP-së, Reshat Fetahu dhe Muharrem Arifi.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdaliu- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11 dhjetor 2013;
3. Shqyrtimi i ecurive lidhur me përpilimin e Regjistrit qendror për personat e zhdukur;

4. Shqyrtimi i Peticionit të grupit monitorues të ish- NSH “Trasing” në Prishtinë;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 nëntor 2013

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19 nëntor, nuk është përkthyer në gjuhën serbe dhe se miratimi i tij do të bëhet në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i ecurive lidhur me përpilimin e Regjistrit qendror për personat e zhdukur

Kryetarja- Për këtë pikë të rendit të ditës, kemi ftuar personat kompetentë për këtë çështje dhe i falënderoj që iu kanë përgjigjur ftesës. Fillimisht është mirë të ndalemi te fillimi i gërmimeve në Rudnicë të Rashkës. Dihet se ka rezultate në këtë drejtim dhe kemi të dhëna se kemi gjetje të mbetjeve mortore atje, e pastaj do të diskutojmë për regjistrin.

Prenk Gjetaj- Gërmimet që po bëhen në fshatin Rudnicë të Rashkës dhe për gjetjet e para të mbetjeve mortore të cilat i kemi pritur me vite të tëra, informatat për këtë vend kanë rrjedhur menjëherë pas luftës dhe më vonë janë përpunuar në vitin 2007, 2008 dhe 2010, ku është bërë një gërmim i cili nuk ka rezultuar me gjetje. Kemi vazhduar edhe më tutje të bashkëpunojmë me dëshmitarë të mundshëm dhe informacionet që i kemi mbledhur së bashku me imazhet satelitore ka pasur ndryshime në konfiguracionin e asaj kënete dhe pastaj edhe ndërtimi i një ndërtese në atë vend në të cilin kemi dyshuar se nën të gjendet varreza.

Me rifillimin e punimeve më 10 dhe 11 dhjetor, kemi qëndruar atje një delegacion, ku dëshmitari kryesor në gjetjen e mbetjeve ka qenë Arsim Gërxhaliu, i cili do të na njoftojë më në detaje.

Ai tha se do të bëhet një raport se çka është bërë, çka është gjetur dhe se me këtë raport do të njoftohen të gjitha institucionet dhe familjarët e personave të zhdukur, sepse po shpresojmë që sadopak numri i personave të zhdukur do të zvogëlohet me gjetjen e mbetjeve në fshatin Rudnicë të Rashkës, ku dyshohet se janë 250 deri 450 viktima, por këto njëherë mbeten vetëm dyshime dhe nuk mund të asgjë.

Arsim Gërxhaliu-Dihet se ka pasur gropime në disa vende, por kanë përfunduar pa rezultate. Tani në këtë vend, deshi fati që në një largësi prej 80 cm nga ajo ndërtesë, aty luga e ekskavatorit që largoi dheun, të dalin mbetjet mortore, rrobat dhe jep një vërtetësi që ka një varrezë në atë vend të dyshuar, dhe deri tani, mbetjet e pesë personave janë gjetur dhe tani pritet një takim me prokurorin për krime të luftës, sepse këto janë procedura që duhet të respektohen dhe të shikohet për veprime të mëtejme. Ajo ndërtesë duhet të rrënohet dhe të largohet ajo shtresë e asfaltit. Duhet të presim kohë më të mirë, sepse tani nuk mund të punohet me makineri të rëndë, por duhet të punohet me vegla dore dhe ngadalë për t'i ruajtur mbetjet mortore.

Kryetarja- Është dyshuar se atje ekziston një varrezë masive dhe kemi qenë të pakënaqur kur janë ndërprerë punimet në tetor, në mënyrë të njëanshme, mirëpo tani është mirë që me ftesë nga Serbia, jeni aty dhe janë duke u bërë gërmimet. Shpresojmë që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Rita Hajzeraj-Dihet që ka pasur disa tentime për gjetjen e varrezave masive në Serbi, por rezultati ishte i pashpresë se diçka do të gjinden aty, dhe tani ky zbulimi i fundit, po del se ka varreze në atë vend të dyshuar. Mua më intereson të di pse ftesa ju është bërë nga ana e Serbisë, keni shkuar atje dhe ditën e parë jeni refuzuar, dhe se ekzistojnë disa proceduara të cilat familjarët nuk i dinë. Sa do të zgjasin këto procedura, a keni mjaft mbështetje nga shteti i Kosovës, nga EULEX-i dhe çka do të duhet që këta trupa sa më shpejt të verifikohen dhe familjarëve t'u kthehen trupat që i presin, dhe a dyshohet se afër kësaj varreze të ketë edhe varreza të tjera, si dhe prej cilit rajon dyshohet se janë këto viktimat?

Prenk Gjetaj- Tha se lidhur me vonesat, ka pasur arsye se ka disa pengesa teknike. Ne kemi qenë të përkushtuar se do të qëndrojmë aty, derisa të fillojnë punimet. Tani është me rëndësi që puna ka filluar dhe çështjet e tjera do të shqyrtohen më vonë. Dyshohet edhe për dy lokacione të tjera që janë të shënuara, por janë dyshime dhe mbetet për t'u vërtetuar, ndërsa sa i përket rajonit që mund t'i përkasin viktimat, nga zëvendësprokurori Bruno, në maj të vitit 2010 na është thënë se janë nga rajoni i Drenicës, por as kjo nuk është e sigurt dhe mbetet për t'u vërtetuar.

Arsim Gërxhaliu-Për çdo vend që është i dyshuar, do të punohet. Para dy viteve kemi hapur 80 lokacione, vetëm tri kanë rezultuar pozitive, sepse tani informatat janë të stërvjetruara, informacionet janë të varfra. Sa i përket dy vendeve tjera, edhe ato janë parë në incizimet satelitore të lëvizjes së dheut në kohën e luftës dhe çdo lëvizje e dheut merret si vend i dyshuar.

Kryetarja-Thatë se shpresoni se do të keni përkrahje nga institucionet, për çfarë përkrahje e patët fjalën dhe a kuptohet që deri më tani, nuk keni pasur shumë përkrahje, për çfarë përkrahje keni menduar dhe keni nevojë?

Arsim Gërxhaliu- Së paku procedurat burokratike duhet të lehtësohet, duhet të ndjekim procedura me anë të kërkesave për gjithçka.

Agim Gashi- Kryqi i Kuq Ndërkombëtar ka qenë prezent kur janë zbuluar mbetjet mortore në Rudnicë dhe konsiderohet se është herët që të jepen më shumë detaje, sepse tani konsiderohet që ekspertë të lëmive të ndryshme dhe ata mjeko - ligjor, të takohen dhe të evidentojnë hapat e mëtejshëm në këtë drejtim.

Albana Gashi- Çfarë ndihme ka pasur Komisioni qeveritar nga partnerët ndërkombëtarë, sidomos te pamjet satelitore, të cilat kanë ndihmuar në gjetjen e këtij lokacioni, sa do të ketë ndikim kjo që në të ardhmen të gjenden lokacione të tjera, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi nga pamjet satelitore, ndërsa dihet se prej vitit 2007 është dyshuar për këtë varrezë masive në Rudnicë, kur ka filluar bashkëpunimi juaj për zbulimin e varrezave?

Prenk Gjetaj- Shfrytëzimi i imazheve satelitore nga forcat e NATO-s, është bërë në momentin që kemi dështuar në vitin 2007 për përcaktimin e vend lokacioneve dhe atëherë kemi kërkuar

ndihmesë në këtë drejtim, për të cilin na kanë shtyrë dëshmitarët, dhe në bazë të këtyre imazheve, ekspertët e EULEX-it kanë shkuar dhe kanë përcaktuar lokacionin.

Albana Gashi- Më intereson të di se a do të shërbejeni me modele të imazheve satelitore të ngjashme për zbulimin e vend lokacioneve të tjera?

Kushtim Gara- Kjo varet shumë nga lloji i vendit të varrezës, nga dëshmitë që ofrohen.

Agim Gashi- Sa i përket imazheve satelitore, imazhet e para janë siguruar nga Zyra e UNMIK-ut, e pastaj nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, duke u bazuar në kërkesën e dy delegacioneve ka kërkuar nga shtetet të cilat kanë kontingjente në kuadër të KFOR-it, të sigurojnë imazhe sa i përket Rashkës dhe kemi marrë imazhe të cilat janë përdorur, ndërsa sa i përket imazheve të tjera, na është thënë se nëse kemi ndonjë indikacion, duhet të bëjmë kërkesë dhe ndoshta do të mund të na i sigurojnë, tani nuk kemi imazhe të tjera për t'i analizuar.

Biserka Kostic – tha se është gezuar me faktin se ka përparime në këtë çështje dhe tha se kjo është pozitive edhe për të gjithë qytetarët. Ajo tha se shembullin e Serbisë duhet ta ndjekin edhe shtetet e tjera me qëllim të zbulimit dhe identifikimit të varrezave masive. Ajo tha se varrezat masive paraqesin plagë dhe nëse këto plage nuk mbyllen do të ndikojnë në përçarjen dhe destabilizimin e regjionit. Ajo po ashtu theksoi se secili ka dëshirë që ti gjeje të dashurit e tyre gjallë mirëpo duhet të pajtohen me fatin. Duke u ndërlidhur me incizimet satelitore ajo pyeti se sa vende potenciale për varreza masive ekzistojnë në Serbi dhe në Kosovë. Ajo pyeti lidhur me rastin e Zhilivodës së çka ka ndodhur me atë rast, a është mbyllur rasti dhe çka është vendosur lidhur me këtë rast.

Prenk Gjetaj-Për varrezat potenciale në Serbi, kemi dyshime dhe tani këto dyshime veç sa po përforcohen me rastin e gjetjeve në Rudnicë. Çdo gjë që disponojmë, ia prezantojmë palës së Beogradit përmes grupit punues. Në Petrovosello ka pasur rreth 80 gjetje, për ne është opsion i hapur verifikimi i varrezës në Batajnicë, sepse dyshojmë a janë verifikuar dhe pastruar këto gropa. Një vend lokacion në fshatin Svirçë në Medvegjë, ka rezultuar negativ. Të gjitha vendet e dyshuara, verifikohen me kërkesë. Gjithashtu, edhe në Zhilivodë, jemi të gatshëm për të bashkëpunuar, sepse punojmë barabartë për fatin e personave të zhdukur dhe të gjithë këta e kanë një përkatësi etnike, janë të zhdukur.

Arsim Gërxhaliu- Zhilivoda është një rast i punimeve unike në botë, nuk ekziston askund tjetër një hapje aq e madhe sa ajo që ka ndodhur në Zhilivodë, ndërsa në asnjë rast ne nuk themi që ka përfunduar. Ka përfunduar për atë moment, sepse atë që kemi kërkuar nuk kemi gjetur. Me dhënien e informatave shtesë, që çdoherë furnizohemi, ne përsëri kthehemi. Aty kemi hequr me miliona kubikë dheu, me ndihmën e FSK-së. Në vitin e ardhshëm janë të planifikuara 40 vende për hapje, krejt këto të bazuara në informacione.

Kimete Bytyçi- U cek se 5 persona janë gjetur, dhe nëse të tjerët gjinden, pos që bëhet autopsia në Beograd, a do të bëhet autopsia edhe në Kosovë, pas kthimit të atyre trupave?

Arsim Gërxhaliu- Tha se të dy komisionet punojnë mirë në aspektin humanitar dhe nuk kemi pasur probleme në këtë aspekt. Kërkesa jonë është që direkt prej Rashkës t'i sjellim në

departamentin tonë, edhe pse Serbia e ka primatin për një gjë të tillë, sepse janë në territorin e saj, por duke pasur parasysh bashkëpunimin e mirë mes dy komisioneve, dëshira jonë është t'i sjellim në departamentin tonë dhe të punojmë bashkërisht me ekipe të përziera, si dhe të fitojmë në kohë, sepse nga aspekti profesional, bashkëpunimi mes komisioneve nuk mungon dhe nuk e kemi këtë problem.

Kymete Bajraktari- Në Raportin e Progresit është përmendur që Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka bërë një kërkesë për varrezat në Maqedoni, ju si Komision qeveritar a keni bërë një kërkesë të tillë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për të filluar këtë proces, sepse është e përmendur që Maqedonia nuk ka një kërkesë prej Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për të filluar një proces atje.

Kryetarja- Kjo çështje ka qenë e cekur edhe në Raportin e Progresit të vitit të kaluar dhe ne e kemi pasur si pikë për diskutim, ku ka qenë ministri i Punëve të Jashtme në raportim për këtë pike dhe ka thënë se nuk ka vend të dyshuar në pjesën e Maqedonisë, dhe për këtë arsye, s'e kam parë të arsyeshme që të arrijmë një bashkëpunim për të filluar gërmimet në rajonin e Maqedonisë.

Kymete Bajraktari- Tha se nuk dëshiron të hyjë në kronologji, por në Raportin e Progresit prapë është kjo çështje, mungon kërkesa e ministrit të Drejtësisë për shtetin e Maqedonisë.

Kushtrim Gara- Në Raportin e Progresit thuhet se ka mungesë të një memorandumit në mes Kosovës dhe Maqedonisë për një marrëveshje, që do të thotë se kërkesë ka, por mungon marrëveshja.

Albana Gashi- Tha se kur ka qenë ministri i ftuar në mbledhje të Komisionit, ka thënë se kanë pasur disa takime me ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë dhe kanë paraqitur këtë problem, mirëpo gjatë këtyre bisedimeve që kanë pasur është dashur ministria jonë t'ju ofrojë fakte atyre se ka një varreze masive atje, duke iu dorëzuar prova për një varreze ekzistuese. Ajo tha se e kemi edhe rastin e Shqipërisë.

Kushtrim Gara- Tha se në takimin e radhës, kurdo që do ta mbani, do ta sjellim edhe kopjen e kërkesës me vete.

Arsim Gërxhaliu- Tha se për 5 raste janë bërë autopsi në Shkup, ekziston incizimi i trupave në lepec, duke shkuar nga Maqedonia. Ne nuk e akuzojmë Maqedoninë, ne kërkojmë ndihmë nga Maqedonia, që nëse është bërë autopsia, kujt i janë dorëzuar dhe ku ka përfunduar fakti i tyre. Ai tha se kam shumë kërkesa prej shumë familjarëve për kohën e eksodit sa ka qenë refugjat në Shqipëri e Maqedoni, e ata neve po na fajësojnë se kanë pasur raste të vdekjeve në fazën e atij tremujori dhe janë varrosur atje nëpër vende të ndryshme dhe nuk kanë mundësi t'i sjellin. Për çdo ditë kam kërkesa të tilla, ndërsa procedurat janë të rënda dhe nuk po kanë mundësi t'i sjellin, sepse kushton shumë. Shumica kanë shprehur vullnetin për t'i riatdhesuar familjarët e tyre të varrosur atje.

Kryetarja- Jam e mendimit që për këtë çështje të bashkëpunimit me Maqedoninë, është mirë të ftohet prapë ministri në mbledhje të Komisionit dhe se tani po kalojmë në pikën e rendit të ditës,

për çka edhe iu kemi ftuar. Sa i përket regjistrit qendror për personat e zhdukur, kemi informata se ai regjistër është në përpilim e sipër dhe se në atë regjistër kanë hyrë shumë emra. Më intereson se në çfarë faze është puna rreth këtij përpilimi të regjistrit dhe si është bashkëpunimi mes institucioneve përgjegjëse për këtë.

Kushtrim Gara- Çështja e regjistrit qendror për personat e zhdukur vazhdon të mbetet prioritet për institucionet e Kosovës dhe është edhe një obligim ligjor i yni. Problemi ka qenë se në Kosovë ka pasur më shumë se një listë të personave të zhdukur dhe ideja ka qenë që të gjitha këto t'i centralizojmë dhe t'i vendosim në një regjistër qendror. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka qenë institucioni i vetëm, i cili ka qenë adresa e vetme që familjarët kanë ditur dhe kanë pasur derën e hapur për të shkuar dhe për të paraqitur një rast për personin e zhdukur. Ajo listë ka qenë pranuar nga të dyja palët, si nga ana e Kosovës, ashtu edhe nga ajo e Serbisë, e cila edhe tani vazhdon të jetë si listë zyrtare e personave të zhdukur. Aktualisht, numri i personave të zhdukur në Kosovë është 1721 persona.

Në qershor të vitit 2012, kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, përmes së cilës Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka ofruar si donacion për blerjen e bazës së të dhënave ante moruem, post mortum, i cili është instaluar në serverin e Ministrisë së Administratës Publike, i cili është duke u punuar nga ana e zyrtarëve të angazhuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore, enkas për regjistrimin e të dhënave zyrtare, që tashme janë në arkivin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, ku deri tani janë përfunduar të gjitha e rastet hapura të personave të zhdukur. Numri i tyre tejkalon edhe numrin 1721, sepse në kohën kur është migruar lista e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, numri i personave të zhdukur ka qenë 1776 persona të zhdukur.

Jemi në fazën e përgatitjes për vitin 2014. Në takimin që e kemi pasur, e që iu referova edhe më herët, jemi dakorduar me ministrin e Drejtësisë, që përmes dy shkresave zyrtare, njëra përmes Komisionit qeveritar dhe njëres nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, t'i krijojmë mundësi Ministrisë së Drejtësisë që të fillojë prapë procedurën për të vazhduar ky projekt që ka filluar qysh në vitin 2012 dhe të vazhdohet edhe në vitin 2014, që nënkupton regjistrimin e të dhënave për personat, fati i të cilëve dihet dhe është fjala për rastet e mbyllura. Komisioni qeveritar është i obliguar të miratojë edhe rregulloren mbi regjistrin qendror, me të cilin do të definojë të gjitha procedurat e regjistrimit, menaxhimin, mbajtjen e të dhënave, daljen e tyre, publikim e mundshëm, e të gjitha.

Biserka Kostiq- Sa i përket regjistrit qendror për personat e zhdukur, a ka bashkëpunuar Komisioni Qeveritar i Kosovës, me Komisioni qeveritar për personat e zhdukur në Serbi për hartimin e këtij regjistri?

Agim Gashi - Duke u ndërlidhur theksoi se Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar e ka nënshkruar një marrëveshje me Komisionin Qeveritar, me qëllim të ndihmës së Komisionit Qeveritar për donacion të një softueri, si dhe ta përkrahin Komisionin në futjen e të gjitha të dhënave, që nënkupton pajisjen e Qeverisë me listën apo regjistrin e personave të zhdukur. Në vazhdim, theksoi se është zvarritur procedura për disa çështje teknike, sepse ka qenë e paraparë që kjo të përfundojë më herët. Ai, po ashtu, kërkoi që të përshpejtohet nxjerrja e akteve nënligjore, të cilat nuk e kanë të caktuar kohën e nxjerrjes, sidomos nxjerrja e aktit nënligjor për Regjistrin qendror.

Arsim Gërxhaliu – Duke u ndërlidhur me këtë theksoi se ata bazë e kanë listën e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe deri sa të krijohet regjistri ata do të punojnë me atë listë.

Kryetarja -Lidhur me këtë, theksoi se ata e dinë mirë rëndësinë që ka regjistri dhe për këtë arsye ka qenë e nevojshme që të krijohet një regjistër i tillë. Po ashtu, theksoi se nuk do të ishte në rregull që mos të vazhdohen kontratat e atyre punëtorëve, të cilët i kanë kryer trajnimet lidhur me krijimin e regjistrit qendror.

Biserka Kostic – Kërkoi falje dhe theksoi se ndoshta është thënë mirëpo ajo nuk e ka kuptuar pasi që sipas mendimit të saj përkthimi ka qenë joprofesional dhe nuk ka arritur të kuptojë. Sa i përket regjistrin, ajo bëri pyetje se a do të përfshihen në regjistër vetëm personat e zhdukur të cilët kërkohen apo do të përfshihet komplet raporti së bashku me regjistrin me personat e zhdukur të cilët kërkohen.

Kushtrim Gara - Theksoi se bashkëpunimi i Komisionit në këto çështje, ka qenë në nivel dhe tani do të përpiqen që në disa takime të grupeve punuese, do të tentojnë të kërkojnë të dhëna lidhur me disa raste, për të cilat dosjet i ka pala serbe. Ai, në vazhdim, tha se projekti është zhvilluar në dy faza: faza e parë ka përfshirë listën aktive që nënkupton personat që ende janë të zhdukur, si dhe faza e dytë që përfshin rastet që janë të mbyllura dhe përpjekjet për t'i identifikuar mbetjet mortore që janë në Morgun e Spitalit të Prishtinës.

Arsim Gërxhaliu - Duke u ndërlidhur me pyetjen se a ka përfaqësues serbë në përpilimin e regjistrin, theksoi se konkursi ka qenë i hapur dhe është problem që po i shoqëron që disa kohë, sepse vazhdimisht kanë kërkuar punëtorë serbë për këtë, mirëpo ende nuk kanë gjetur zgjidhje të kësaj çështje. Ai tha se është pranuar një person, mirëpo ka probleme me diplomën e tij, sepse e ka nga një universitet paralel që nuk e njohin institucionet e Kosovës.

Agim Gashi - Duke u ndërlidhur me regjistrin, theksoi se ai vazhdimisht si liste e përkohshme i dorëzohet palës shqiptare dhe asaj serbe. Sa i përket palës shqiptare, ai tha se në bazë të legjislacionit aktual e kanë të obliguar ta kenë Regjistrin qendror, dhe për këtë arsye, Komisioni ka kërkuar nga ata listën, në mënyrë që të pajiset me të. Sa i përket një anëtarit të komunitetit serb, ai tha se është një vend i hapur, i cili ende nuk është zëvendësuar, edhe pse ka qenë konkursi i hapur, sepse në këtë drejtim po ka probleme që të plotësohet.

3. Shqyrtimi i petitionit të Grupit monitorues të ish- NSH “ Trasing “ në Prishtinë

Kryetarja - I njoftoi të pranishmit se bëhet fjalë për një petition të grupit monitorues të ish-NSH “Trasing “ nga Prishtina, të cilët kanë reaguar për disa paga që nuk i kanë marrë. Lidhur me këtë çështje, ajo kërkoi informacione nga përfaqësuesit e AKP-së.

Muharrem Arifi - Duke u ndërlidhur me pyetjen, theksoi se ata e kanë përgatitur një material rreth historikut të kësaj ndërmarrje, si dhe privatizimit të saj. Ai tha se kjo ndërmarrje ka filluar procesin e likuidimit në vitin 2007, dhe sipas procedurave, të gjithë punëtorëve iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës, pas vendimit të futjes së ndërmarrjes në likuidim. Ai theksoi se kanë pasur disa vonesa në emërimin e përfaqësuesve ndërkombëtarë në komisionet e likuidimit, që ka qenë e pamundur vendimmarrja. Sa i përket kësaj çështjeje, ai tha se punëtorët e kësaj ndërmarrjeje e

kanë marrë në tërësi 20 %-shin dhe janë në pozitë më të mirë se sa punëtorët e ndërmarrjeve të tjera dhe janë më të favorizuar se punëtorët e ndërmarrjeve të tjera edhe në procesin e likuidimit. Ai tha se Agjencia e ka të pamundur t'ua kthejë paratë me këtë status që e ka për momentin dhe nuk mund ta bëjë ekzekutimin e këtyre pagesave, për shkak të pengesave ligjore. Ai, po ashtu, theksoi se shumica e kërkesave të këtyre punëtorëve për pagat janë aprovuar

Kryetarja - Bëri pyetje se për sa paga të punëtorëve bëhet fjalë në këtë rast dhe shtoi se a do t'i kishin realizuar ata këto paga, nëse Bordi nuk do të ishte pengesë apo këta (punëtorët) nuk kanë të drejtë në këto paga.

Muharrem Arifi - Tha se kjo është çështje që ndryshon nga punëtori në punëtor, varësisht prej numrit dhe muajve të papaguar, mirëpo kjo është e definuar në kërkesa dhe vendime. Ai tha se shumica e vendimeve janë pozitive dhe këta punëtorë do t'i marrin pagat e tyre kur të plotësohen kushtet e përcaktuara me ligj për anëtarin e tretë të Bordit, i cili është ndërkombëtar.

Reshat Fetahu - Lidhur me petitionin e ushtruar, tha se u ngrit një çështje shumë delikate, siç është çështja e Bordit. Në vazhdim, ai theksoi se edhe agjencitë e tjera të pavarura në Republikën e Kosovës, kanë vështirësi në veprimtaritë e tyre, për shkak të moskompletimit të bordeve, mirëpo ai tha se Bordi i Agjencisë Kosovare është më specifik, sepse nuk është bord drejtues, por udhëheqës, i cili ka autorizime të cilat sipas ligjit, nuk mund ta autorizojë askënd që t'i ekzekutojë. Ai përmendi ekzistimin e fondit në të cilin punëtorët janë bashkëpronarë në të dhe sipas tij, kjo e drejtë i takon ekskluzivisht, Dhomës së Veçantë dhe për këtë as gjykata nuk mund të zëvendësojë. Një specifikë të veçantë që ai përmendi, ishte përbërja e Bordit nga tre anëtarë ndërkombëtarë, të cilët e kanë të drejtën që çdo vendim të Bordit ta bllokojnë, kurse tek pagesat ai tha se janë dy mekanizma nga Fondi i Mirëbesimit dhe sqaroi se njëri mekanizëm është vendimi i Dhomës së Veçantë dhe këta e ekzekutojnë, kurse mekanizmi i dytë është me vendim të Bordit, pas procedurës së likuidimit, por edhe në këtë rast kërkohet vota unanime e tre anëtarëve ndërkombëtarë dhe pikërisht këtu është problemi.

Albana Gashi -Pyeti: Për sa kohë është Bordi i pakompletuar?

Reshat Fetahu - Duke u ndërlidhur, theksoi se Bordi, që nga muaji prill, është i pakompletuar, por edhe në vitin e kaluar nëntë muaj kanë qenë pa kryesues.

Albana Gashi -Kjo ndërmarrje është privatizuar më herët dhe procesi i likuidimit ka filluar në vitin 2007. Ajo tha se është kohë e gjatë dhe pse ka ngecur procesi këtu. Përmendi se raste të tilla ka edhe në ndërmarrje të tjera dhe nuk është tani vetëm kjo ndërmarrje.

Muharrem Arifi -Historiku i procesit të likuidimit përbëhet nga dy faza. Faza e parë është gjatë kohës së AKM- së, që ka funksionuar deri më 30 qershor 2008, si dhe koha e fillimit të punës së AKP-së që ka filluar nga gushti vitit 2008. Ai i informoi se deri më tani, prej kur kanë filluar punën ata, kanë marrë 37 800 vendime të ngjashme me rastin e ndërmarrjes "Trasing". Po ashtu, ai i informoi se janë 340 ndërmarrje tani janë në procesin e likuidimit.

Kryetarja - Theksoi se problemi është tek Bordi, sepse këta e kanë marrë vendimin për kompensimin e pagave.

Muharrem Arifi - Theksoi se pengesa në procesin e likuidimit janë Dhoma e Veçantë dhe Bordi.

Kurtan Kajtazi – Bëri pyetje se a kanë bërë padi punëtorët e ndërmarrjes “Trasing” në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Muharrem Arifi – Lidhur me ndërmarrjen “Trasing” është çështja e kryer, por pengesa për këtë është kompletimi i Bordit, sepse të gjitha veprimet e tjera janë përfunduar dhe vetëm emërimi i anëtarit të ri ndërkombëtar në Bord e mundëson ekzekutimin e këtyre vendimeve, konkretisht realizimin e pagesave për të cilat ata kanë bërë peticion.

Kurtan Kajtazi – Është përgjegjësi totale e institucioneve tona, po edhe të atyre ndërkombëtare që të krijohen këto pengesa tek të gjitha ndërmarrjet, të cilat janë në procesin e likuidimit, për shkak të mungesës së një anëtar ndërkombëtar.

Reshat Fetahu – Informoi se në procesin e likuidimit formohet një kuazitribunal me ligj dhe të gjitha paditë që janë kundër ndërmarrjeve, ndërpriten në gjykata dhe këta marrin vendime. Në qoftë se ato vendime janë negative, palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesa në Dhomën e Veçantë. Sa i përket këtij rasti, ai tha se këtu nuk ka çështje që duhet të shkojë në Dhomë të Veçantë, sepse këta i kanë aprovuar kërkesat e tyre dhe janë lëshuar vendimet, mirëpo problemi është tek realizimi i pagesave. Ai i informoi se raportin final të likuidimit e aprovon gjykata, kurse në rastin e ndërmarrjes “Trasing”, gjykata nuk e ka aprovuar raportin final të likuidimit. Ai, po ashtu, i informoi se në këtë ndërmarrje ka tepriçë të hollave, diku rreth 1 milion, ndërsa me vendim të Bordit, aty ku ka tepriçë të parave, ato të holla deponohen në Buxhet të Kosovës.

Albana Gashi – Pyeti se a kanë marrë ndonjëherë ndonjë ankesë nga punëtorët apo ish-punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuar dhe cilët janë hapat që i kanë ndërmarrë, sepse ajo tha se ka shumë ndërmarrje të cilat nuk e kanë vazhduar veprimtarinë e tyre pas privatizimit.

Reshat Fetahu – Tha se ka vërejtje nga punëtorët. Ai bëri sqarime rreth mënyrave të privatizimit të cilat janë bërë me likuidim, privatizim të thjeshtë dhe “Spin of Special”. Kurse me ligjin e ri të vitit 2012, nuk ekziston privatizimi me “Spin Of Special”.

Albana Gashi – Duke u ndërlidhur, sërish bëri pyetje se çka ka ndodhur me ato ndërmarrje të cilat janë privatizuar me “Spin of Special”, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret dhe si veprojnë ata me këto ankesa.

Reshat Fetahu – Këto ankesa i drejtohen Bordit dhe Bordi i shqyrton. Kurse lidhur me çështjen e mospërmbushjes së kriterëve nga ana e blerësit, ai tha se pas paraqitjes së kërkesës në Bord, formohet një auditim për ta konstatuar gjendjen, dhe nëse konstatohen shkaqet, atëherë ndërmarrin veprime konkrete, mirëpo lidhur me ankesa të tilla, ai tha se në shumicën e rasteve këto kanë rezultuar me ankesa të pabazuara. Lidhur me raste të tilla, ai tha se ka ndodhur që për një ndërmarrje kanë angazhuar tri herë auditime, vetëm për të konstatuar sa më realisht gjendjen dhe në ato raste kur kanë gjetur vërejtje, ata e kanë marrë ndërmarrjen.

Albana Gashi – Duke u bazuar në rastin konkret të ndërmarrjes “Suhareka “, tha se ka pasur ankesa për këtë ndërmarrje dhe nuk ka nevojë për analiza të thella, sepse aty vërehen nga jashtë keqpërdorimet që janë bërë në këtë ndërmarrje, duke u fokusuar në Bodrumin që është shkatërruar dhe është shitur, pastaj vreshtat që janë shkatërruar, po ashtu edhe tek ndërmarrja “Ballkani” nuk janë respektuar kriteret, sepse nuk është mbajtur numri i caktuar i punëtorëve dhe nuk janë bërë investimet e caktuara me “Spin of Special”.

Kryetarja – Ndërhyri duke thënë se ata janë të ftuar vetëm për petitionin e ndërmarrjes “TRASING”.

Muharrem Arifi – Theksoi se NBI “Suhareka” është shitur me “Spin Of Special”, si AKP, asnjë shitje të tillë nuk e kanë bërë d.m.th. këto shitje janë bërë vetëm në kohën e veprimtarisë së AKM-së dhe këto janë trashëguar. Ai i përmendi disa raste ku janë marrë ndërmarrjet, për shkak të keqpërdorimeve. Lidhur me rastin “Suhareka”, ai tha se nuk ka përfunduar procesi i heqjes së monitorimit të kësaj ndërmarrjeje nga Bordi, dhe në momentin e përmbushjes së obligimeve, Bordi del me qëndrim të caktuar, varësisht nga situata e konstatuar.

Albana Gashi – Pyeti se sa kohë mund të zgjasë procesi i monitorimit.

Muharrem Arifi – Tha se procesi i monitorimit bëhet në kontratë, por është në kompetencë të Bordit që ta vazhdojë këtë, nëse ka arsye të bindshme për një gjë të tillë.

Albana Gashi – Theksoi se është e pakuptimtë të zgjasë monitorimi pa afat, përderisa kjo ndërmarrje thuhet se është rrënuar dhe nuk ka mbetur asgjë aty.

Muharrem Arifi – Tha se lidhur me këtë, ata do të shikojnë kontratën, në mënyrë që që ta vërtetojnë se çfarë obligimesh kanë pasur në këtë rast blerësit dhe deri ku ka mbërri zbatimi i atyre obligimeve dhe kur do të përfundojë mandati për këtë.

Kimete Bytyçi – Duke u ndërlidhur me çështjen e 20 %-shit, pyeti se a ju është shpërndarë shuma e 20 %-shit, të gjithë punëtorëve apo disa raste po, e në disa raste jo, sepse ka informacione se në rastin e ndërmarrjes OBI, nuk iu është shpërndarë të gjithë punëtorëve shuma e 20 %-shit. Po ashtu, ajo pyeti se a i kanë njoftuar me shkrim, paraprakisht, të gjithë punëtorët e ndërmarrjes së theksuar më lart, në mënyrë që ata të kenë njoftimin me shkrim për ta bërë kërkesën për shumën 20 %. Po ashtu, ajo tha se nuk është e drejtë që mos t’i jepet shuma e 20 %-shit familjarëve të punëtorit i cili ka vdekur, sepse është shkelje e të drejtave të njeriut.

Muharrem Arifi – Duke u ndërlidhur me pyetjen, tha se çështja e futjes në listë është çështje e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kurse sa i përket informimit të punëtorëve, ai tha se kompetente për informim është sindikata e asaj ndërmarrje, sepse agjencia nuk mundet t’i njoftojë të gjithë punëtorët. Lidhur me përbërjen e listave të punëtorëve, ai tha se në rastet kur ka kundërshtime për punëtorin e caktuar, atij punëtori nuk i jepet shuma e 20 %-shit, deri në momentin kur Dhoma e Posaçme e merr vendimin e formës së prerë.

Kryetarja- Konstatohet se pas këtij debati konstruktiv, Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I.
 1. Mosekzekutimi i pagave të ligjshme nga ana e AKP-së, për ish- punëtorët e NSH “TRASING” në Prishtinë, është pasojë e mosplotësimit të vendeve të zbrazëta në Bordin e AKP-së, i cili funksionon sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Nr. 04/L-034.
 2. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, nuk e ka në fushëveprim Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe si rrjedhim as procedurën për plotësimin e Bordit të AKP-së.
 3. Komisioni, mbi bazën e këtij peticioni, do të angazhohet te subjektet tjera relevante, për përshpejtimin e procedurës së plotësimit të vendeve të zbrazëta në Bordin e AKP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu